

Takim pune mes Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe SIGMA

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi), zhvilloi një takim pune me përfaqësuesin e SIGMA, për Shqipërinë, z. Timo Ligi, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit institucional dhe vijimit të dialogut të nisur më herët.



Diskutimet u fokusuan në prioritetet kryesore të institucionit, përfshirë hartimin e një strategjie institucionale afatmesme, rishikimin dhe standardizimin e akteve dhe proceseve të punës, zhvillimin e indikatorëve të matshëm të performancës, si dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit.

Zyra e Komisionerit riafirmoi gatishmërinë për një bashkëpunim të strukturuar dhe afatgjatë me OECD/SIGMA, me synimin e ndërtimit të një partneriteti funksional që kontribuon në forcimin e administratës publike dhe të shtetit të së drejtës.

